

LIGJ
Nr.9206, datë 17.6.2004

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8461, DATË 25.2.1999 “PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.9120, DATË 28.7.2003

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.9120, datë 28.7.2003, në nenin 28, pas fjalisë së parë të paragrafit të parë bëhet shtesa si më poshtë:

“Personeli akademik i brendshëm me titullin “Profesor” shërben në detyrë deri në moshën 68 vjeç, me përjashtim të rastit kur, me kërkesën e tij, lirohet nga detyra për arsye të plotësimit të moshës së pensionit, sipas neneve 31 dhe 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.2003 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kjo dispozitë ka efekt vetëm për subjektet e mësipërme që kanë mbushur moshën e pensionit, por jo mbi 68 vjeç.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4269, datë 14.7.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu